

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRA PËRMBARIMORE ARBEN MELONASHI  
SKY CAFE

Rr. Sedat Babani nr 4, L. 3, Korçë, Cel.: 0355662035923; melonashi@gmail.com  
Certifikate nr. 118; NIPT: L24804002M; QKL: LN-5933-12-2012/XI 2; IBAN: AL89202410030000000000593734

Nr. 943/1 Prot.

Korçë, me 5/4/2017

Nr. 179 Rregj.

**URDHER**  
**(Për vënien e sekuestro konservative)**

**DREJTUAR:** Qendres Kombetare Te Bisnesit (QKB)  
Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nr.3, Kati I

**Për dijeni:** "Aliu Road House" sh.p.k., me (NIUS) K83211201N, me perfaqesues zyrtar Isa Aliu  
Adresa: Lagjia Beqir Dardha, Pallati 41/6, Elbasan (Prane Pedagogjikes).

"Fix Pro" sh.p.k., me (NUIS) K83715001N, me seli ne Lagjia 1, Rruga Eordej, Korçë

Unë Arben Melonashi, Përmbaarues Gjyqësor, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, bazuar ne "Urdhrin e Ekzekutimit" me Nr. 439 Akti, të lëshuar me datë 27.02.2017 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë,

**KONSTATOVA :**

Se ne date 27.03.2017 është regjistruar pranë Zyrës se Përmbaaruesit Gjyqësor kërkesa e palës kreditore se bashku me "Urdhrin e Ekzekutimit" për titullin ekzekutiv, "Faturat Tatimore" te pasyrura ne Kartelen e Klientit, me pale:

**-Kreditor:** "Fix Pro" sh.p.k., me (NUIS) K83715001N

**-Debitor:** "Aliu Road House" sh.p.k., me (NIUS) K83211201N

**-Objekti:** Detyrimin e palës debitore likuidimin e shumës 552,163 LEKE me tvsh, (shume e arritur deri ne date 13.03.2017) + tarifen përmbarimore

Lidhur me ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv kane vazhduar procedurat ligjore sipas neneve 517, 518, 519 e vijues te K. Pr. Civile si dhe te ligjit nr. 10031 date 11/12/2008 "Për Organizimin dhe Funkcionimin Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat" i ndryshuar. Ne kushtet kur për ekzekutimin e "Urdhrit te Ekzekutimit", duhet te kryhet sekuestrimi i pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, (llogarive, depozitave bankare, mjeteve motorik prona te paluajtshme, asetë, aksione etj.) te pales debitore për vjeljen e detyrimit ne shumën prej 552,163 LEKE me tvsh, (shume e arritur deri ne date 13.03.2017) + tarifen përmbarimore, tarifen e shërbimit përmbarimor, për ekzekutimin e titullit ekzekutiv ne favor te kreditoreve.

Ne zbatim te neneve 527 te K. Pr. Civile dhe nenit 46 te ligjit Nr. 10031 date 11/12/2008 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat" i ndryshuar,

**URDHEROJME :**

**1)-** Qendren Kombetare Te Bisnesit (QKB) pas verifikimi te vendose masën e sekuestros konservative (bllokimin) mbi pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme asetet, aksionet, kuota te debitorit Aliu Road House" sh.p.k., me (NIUS) K83211201N, me perfaqesues zyrtar Isa Aliu me seli ne Lagjia Beqir Dardha, Pallati 41/6, Elbasan (Prane Pedagogjikes), si dhe te gjitha te drejtat qe rjedhin nga zoterimi asetëve, aksioneve, kuotave etj... me qellim për vjeljen e detyrimit ne shumën prej 590,503 leke, për ekzekutimin e titullit ekzekutiv ne favor te pales kreditore "Fix Pro" sh.p.k., me (NUIS) K83715001N.


Pas vënies se sekuestros te informohemi shkreserisht (zyrtarisht) ne lidhje me:

- A) Kryerjen e bllokimit per moslejimin e çdo lloj tjetërsimi qe ka si qellim pakësimin apo zvogëlimin (ndryshim, shitje, blerje, dhurim etj.) te asetëve, pasuri te luajshme/paluajshme, aksioneve apo kuatave te kësaj shoqërie;
- B) Datën e miratimit për implementimin e këtij urdhri;
- C) Datën e publikimit nga QKR, sipas nenit 45 te Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007.

Lidhur sa me sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor, si dhe për personat qe bëhen pengese ne zbatimin e këtij urdhri do te merren te gjitha masat e parashikuara ne nenin 606 te K. Pr. Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kërkohet ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.
- Ky urdhër është ne disa kopje: Një kopje u dërgohet dhe u njoftohet palëve te cilat kane te drejtën e ankimit ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçe brenda **5 (pese)** ditëve nga komunikimi apo marrja dijeni.
- Ky urdhër është ne fuqi deri ne një urdhër te dyte te kësaj zyre, si dhe nëse personi ka pasuri te mos kryhet asnjë veprim por te vendoset sekuestro sipas kësaj urdhërese.

**ZYRA PERMBARIMORE ARBEN MELONASHI T.R.**  
**PERMBARUESI GJYQESOR**  
**ARBEN MELONASHI**



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Arben Melonashi', written over a circular blue stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE - PRIVAT' around the top edge and 'ARBEN MELONASHI' around the bottom edge. In the center of the stamp is a small emblem featuring a double-headed eagle, which is the national symbol of Albania.